



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1384/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Faton Bajrami dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit Kompania Transportuese “Skorobishta Trans” me seli në fshatin Skorobishtë Komuna e Prizrenit, me përfaqësues sipas autorizimit Amer Alija avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, me bazë juridike, anulim vendimi, me kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.241/24 të datës 27.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Kompania Transportuese “Skorobishta Trans” me seli në fshatin Skorobishtë Komuna e Prizrenit, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.241/24 i datës 27.05.2024, VËRTETOHET

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, është Refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit Kompania Transportuese “Skorobishta Trans” me seli në fshatin Skorobishtë Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar të shtyhet nxjerrja e një akti administrativ të njëjshëm nga e paditura Komuna e Prizrenit, në kundërshtim me kërkesën e paditësit, deri në vendim përfundimtar të gjykatës.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak se gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesëpadinë pa e shqyrtuar fare dhe pa hyrë në shqyrtim kryesor, që do të

kontribuon në falimentimin e kompanisë Skorobishta Trans. Paditësit nuk i është mundësuar që të ushtron mjetet e rregullta dhe shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, sepse interesi publik është që kjo kompani vazhdon me linjat dhe rendet e udhëtimit të cekura në kërkesë e po ashtu shtyrja nuk do ti sjell asnjë dëm palës kundërshtare në këtë rast Komunës së Prizrenit.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Dhomat e shkallës së dytë, duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së paditësit, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë- shtyrjen e vendimit të njëanshëm të paditurës Komuna e Prizrenit, ka gjetur se nuk mund të kërkohej shtyrja e nxjerrjes së aktit administrativ në kuptim të nenit 22 të LKA-së, mund të kërkohej vetëm shtyrja e vendimit përfundimtar në procedurën administrative ekzekutimi i të cilit do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej. Kërkesa e paditësit është kundërthënëse dhe paragjyquese sepse në njërën anë me padi kërkon nxjerrjen e aktit administrativ nga e paditura, ndërsa me kërkesë për masë propozon shtyrjen e nxjerrjes së aktit administrativ.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, ngase edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që: *shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.*

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar të shtyhet nxjerrja e një akti administrativ të njëanshëm nga e paditura Komuna e Prizrenit, në kundërshtim me kërkesën e paditësit, deri në vendim përfundimtar të gjykatës, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e nxjerrjes së aktit administrativ të paditurës. Meqë në këtë rast paditësi, në ankesën e ushtruar nuk ka

bërë të besueshme pretendimet e tij, se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së, prandaj, pretendimet ankimore se vendimi i pa shkruar i nxjerr nga e paditura Komuna e Prizrenit po i sjell dëm të pariparueshëm paditësit, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, vlerësoi këto pretendime si të pabazuara dhe të pa argumentuara. Sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj gjykate, aktvendimi i atakuar i Dhomës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhomat e shkallës së dytë.

Pretendimet ankimore për shtyrjen e nxjerrjes së aktit administrativ nga e paditura, Kolegji i vlerësoi si tërësisht të pa bazuara në ligj, meqë dispozitat e nenit 22 të LKA-së, përcaktojnë të drejtat e palëve të kërkojnë shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në vendimin definitiv gjyqësor, ndërsa në rastin konkret kemi të bëjmë me inicimin e konfliktit administrativ nga paditësi për shkak të heshtjes administrative nga i padituri Komuna e Prizrenit. Pra nga shkresat e lëndës nuk vërtetohet se e paditura është duke zhvilluar një proces administrativ sa i përket shpalljes publike vijave-rendit të udhëtimit për operatorët e transportit dhe nuk është nxjerr ndonjë akt administrativ nga e paditura, ndaj të cilit mund të iniciohet me padi konflikti administrativ në vështrim të nenit 13 të LKA-së.

Kolegji pajtohet me pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, pasi që përfundimi i saj është i rregullt dhe i ligjshëm, se aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, apo kontestimore, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat shkaqe gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të cilat pretendohen me ankesë.

Mbi këtë gjendje të fakteve, Kolegji gjen se Gjykata e Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të propozimit të paditësit, me të cilën ka kërkuar të shtyhet nxjerrja e një akti administrativ të njëanshëm nga e paditura Komuna e Prizrenit, në kundërshtim me kërkesën e paditësit, deri në vendim përfundimtar të gjykatës. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1384/24 datë 24.07.2024

Kryetari i Kolegjit
Krenar Berisha